



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 211, datë 22.11.2019

**PËR
MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET
AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE DHE QENDRËS PËR
EMANCIPIMIN EKONOMIK TË MEDIAS**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 18, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit në lidhje me bashkëpunimin reciprok për përgatitjen dhe shpërndarjen e informacionit në fushën e tregjeve financiare ndërmjet Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Qendrës për Emancipimin Ekonomik të Medias, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Juridike për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Ervin METE

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI



AUTORITETI I MBIKQYRJES FINANCIARE

Adresa: Rruga "Dora D'istria", Nr.10, P.O. Box 8363, Tiranë, Shqipëri

Tel. 4 2257560, 08006969, 4 2250686; E-mail: amf@amf.gov.al www.amf.gov.al



U N E C E M

QENDRA PËR EMANCIPIMIN EKONOMIK TË MEDIAS

Rregjistruar me Vendim të Gjyqates së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Nr. 85/2003

Adresa: Rr. "M. Shyri", Pall. 44, Shk. 3, Ap. 26, Tiranë-Shqiperi

U N E C E M-Albanian Center for Economic Emancipation of Media

Established on Decision No. 85 dated February 28, 2003 of the Tribunal of Judicial District of Tirana

Tel.: +35542224007; Mob. +355695303280 E-mail: fcocoli@gmail.com

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (në vijim "AMF"), i përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv z. Ervin Koçi dhe Qendra për Emancipimin Ekonomik të Medias (në vijim "UNECEM"), e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Fatos Çoçoli, bien dakord të bashkëpunojnë si më poshtë vijon:

Neni 1

Qëllimi

Përgatitja dhe shpërndarja e një informacioni të përzgjedhur me kujdes dhe të rishkruar lehtësisht, të kuptueshëm për mediat dhe për qytetarin, për veprimtarinë e tregjeve financiare jobankare tek ne dhe kryesisht: tregu i sigurimeve të jetës dhe operatorët e tij; tregu i investimeve kolektive(fondet e investimit) dhe operatorët e tij, si dhe tregu i pensioneve private suplementare dhe operatorët e tij.

Neni 2

UNECM merr përsipër të përgatisë shkrime, profile, intervista dhe analiza për tregjet e mësipërme dhe ecurinë e veprimtarive të tyre, si dhe për trendet e reja të zhvillimit. Për këtë, do të përgatisë, në bashkëpunim me AMF-në dhe me Shoqatën e Siguruesve të Jetës, Pensioneve dhe Fondeve të Investimeve:

1. Një newsletter mujor “**Tregjet Financiare.al**” në dy gjuhë, në versione të veçanta elektronike, 8 faqe A4. Shpërndarja elektronike e newsletter sipas një listë adresash elektronike të rënë dakord mes UNECM, Shoqatës dhe AMF-së për 12 edicione në vit.
2. Portalin “**Financialmarket.al**”, në gjuhët shqip dhe anglisht. Lançimi i portalit në muajt nëntor-dhjetor 2019. Rubrikat kryesore të portalit të dakordësuara mes UNECM, AMF dhe Shoqatës së Siguruesve të Jetës, Pensioneve dhe Fondeve të Investimeve.

Neni 3

UNECM merr përsipër të mbështesë AMF-në në të gjitha aktivitetet e saj, për rritjen e imazhit dhe të mesazheve të AMF-së në publik. AMF merr përsipër të ndihmojë UNECM në sigurimin e informacionit të nevojshëm për realizimin e dy produkteve sipas Nenit 2 të këtij Memorandumi, si dhe ndihmon për adresat zyrtare të e-maileve të partnerëve vendas dhe të huaj të AMF-së, me qëllim shpërndarjen me e-mail të produktit Newsletter “**Tregjet Financiare.al**”.

Në formën e një projekti pilot (për të shpërndarë produktin newsletter dhe informacione njohëse shtesë për tregjet financiare jo-bankare), AMF merr përsipër t’ju dërgojë produktet universiteteve dhe shkollave të mesme me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi, me qëllim shpërndarjen e tyre studentëve, nxënësve dhe stafit të institucioneve përkatëse.

UNECM merr përsipër përgatitjen e broshurave dhe fletëpalosjeve njohëse si për nivelin e studenteve universitarë dhe të atij të nxënësve të arsimit të mesëm, lidhur me aktivitetin e AMF-së dhe zhvillimin e tregjeve financiare jo-bankare.

Neni 4

Marrëveshja lidhet për një kohëzgjatje 1(një) vit duke filluar nga data e miratimit të saj në bordin drejtues të AMF-së, me të drejtë rinovimi automatik për të njëjtën periudhë, nëse palët nuk shprehen me shkrim ndryshe.

Lidhur dhe nënshkruar sot në Tiranë, më datën _____.____. 2019.

AUTORITETI I MBIKQYRJES FINANCIARE

**QENDRA PËR EMANCIPIMIN
EKONOMIK TE MEDIAS**

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv

Sekretari i Përgjithshëm

Ervin Koçi

Fatos Çoçoli